



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2020:067372

Datë: 08.03.2024

Numri i dokumentit: 05428527

E.nr.536/23

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, me gjyqtarin Faton Ajvazi, me bashkëpunëtorin profesional Besart Selmani duke vendosur në lëndën e përbarimit të kreditorit S.M. nga Ferizaj, të cilën e përfaqëson av Fadil Sinanaj nga Gjilani, kundër debitorit Qendra e Shëndetit Mendor - Ferizaj, për pagesën e shumës në emër të shpenzimeve të udhëtimit, të ushqimit dhe shpenzimet e procedurës, më datë 08.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

PËRFUNDON procedura përbarimore në lëndën E.nr.536/23, për shkak të përmbushjes së kërkesës së kreditorit.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Ferizaj, me aktvendimin E.nr.536/23, të datës 22/03/2023, e ka caktuar përbarimin e propozuar nga i autorizuari i kreditorëve kundër debitorit Qendra e Shëndetit Mendor - Ferizaj, për pagesën e borxhit dhe shpenzimeve të procedurës, në bazë të pajtimit gjyqësor 2020:067372, të datës 25.01.2022.

Meqenëse aktvendimi mbi lejimin e përbarimit është bërë i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm, gjykata me aktvendimin e datës 12/9/2023, e ka urdhëruar Thesarin e Kosovës pranë Ministrisë së Financave, Punës dhe të Transfereve, që nga llogaria e debitorit ta transferoj shumën e përgjithshme të mjeteve prej 1,792.99euro, në llogarinë e të autorizuarit të kreditorë.

Meqenëse kreditorja e ka realizuar kërkesën e saj, Gjykata konstatoj se janë përmbushur kushtet ligjore nga neni 66, par 4, të LPP-së dhe vendosi që ta përfundoj procedurën përbarimore në këtë çështje juridike përbarimore.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

E.nr.536/23, më datë 08.03.2024

GJYQTARI

Faton Ajvazi